




BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office	
E Dërguar: Prezato: Send to: DLS DPMB	
Data: Dellum: Data: 23.01.24	Nr: Br: No: 98-D-24

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-209, GZ nr. 77/2010, 16 gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03 prill 2017), si dhe në përputhje me nenin 44 të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore, më datë 23 janar 2024, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR ASPEKTET PROCEDURALE TË MARRJES SË LICENCËS DHE AUTORIZIMIT TË VEÇANTË PËR IMPORTIN DHE EKSPORTIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE

8

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim rregullon aspektet procedurale, për institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare që operojnë në Republikën e Kosovës, përkthazi me marrjen e licencës dhe autorizimit të veçantë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Fushëveprim i këtij Udhëzimi janë:
 - 1.1. Aspektet procedurale të procesit të aplikimit dhe marrjes së licencës për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave
 - 1.2. Aspektet procedurale të procesit të kërkesave dhe marrjes së autorizimeve të veçanta për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

Neni 3

Pranueshmëria e kërkesave për pajisje me licencë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 40 të Rregullores për operacione me para të gatshme, vetëm Institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare bankare dhe jo-bankare që operojnë në Republikën e Kosovës kanë të drejtë të aplikojnë për marrjen e licencës për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave.

Neni 4

Kërkesat për pajisje me licencë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Në përputhje me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 40 të Rregullores për operacione me para të gatshme, Institucionet financiare bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare që operojnë në Republikën e Kosovës, për ushtrimin e aktivitetit të importit dhe eksportit të kartëmonedhave dhe monedhave euro dhe valutave të tjera në Republikën e Kosovës duhet të kërkojnë dhe pajisen me një licencë për çdo valutë që synojnë të importojnë apo eksportojnë.
2. Për t'u kualifikuar për një licencë për të kryer importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave, një institucion financiar bankar apo jo-bankar duhet të plotësojë kriteret minimale të mëposhtme:
 - 2.1. Të jetë një institucion financiar bankar apo jo-bankar i licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e aktiviteteve financiare në Republikën e Kosovës.

- 2.2. Të ketë një Policë vjetore të sigurimit me ndonjërin nga kompanitë e sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, për mbulim adekuat të parave gjatë transportit në përputhje me Rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për kërkesat minimale të sigurisë
- 2.3. Të ketë të angazhuar një apo më shumë CIT (Cash In Transit) kompani të licencuara nga institucioni përgjegjës për transport të parave të gatshme në përputhje me Rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për kërkesat minimale të sigurisë
- 2.4. Të zbatojë masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur paratë e transportuara.

Neni 5

Procesi i aplikimit për pajisje me licencë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Në bazë të vlerësimit të nevojave të vet institucionit financiar, parashtrohet një kërkesë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për aplikim zyrtar për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme në Bankën Qendrore, duke përfshiruar, së paku:
 - 1.1. Emrin dhe adresën e institucionit financiar bankar ose jo-bankar që parashtron kërkesën për licencë
 - 1.2. Llojet e transporteve për të cilat kërkohet licenca:
 - 1.2.1. Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për të gjitha valutat pa kufizim në shuma
 - 1.2.2. Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për të gjitha valutat deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë;
 - 1.2.3. Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë
 - 1.2.4. Kërkesë për pajisje me licencë për import të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë; ose
 - 1.2.5. Kërkesë për pajisje me licencë për eksport të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë
 - 1.3. Listën e valutave për të cilat kërkohet licenca, sipas standardit ISO 4217 për kodet e valutave
 - 1.4. Listën e vendeve për të cilat kërkohet licenca sipas standardit ISO 3166 alpha-2 për kodet e shteteve
 - 1.5. Shumat maksimale që planifikohen të importohen apo eksportohen për secilën valute (ekuivalente në EUR)
 - 1.6. Arsyetimi për çdo valutë, rreth nevojës dhe qëllimit për të importuar ose eksportuar
 - 1.7. Mënyrat e planifikuara të transportit (Transport Ajror, Transport Rrugor, Transport Hekurudhor)
 - 1.8. Dëshmi e mbulimit të sigurimit të shumës së parave të gatshme gjatë transportit
 - 1.9. Masat e planifikuara të sigurisë të aplikuara gjatë transportit të parave të gatshme
 - 1.10. Plani vjetor i aktiviteteve të planifikuara dhe frekuenca e transportit të parave të gatshme për çdo valutë
 - 1.11. Politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm dhe të menaxhimit të rrezikut
 - 1.12. Arsyet kryesore pse një furnizim i tillë nuk do të mund të bëhet përmes Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin mbështetës sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe paraqiten pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës
3. Aplikimet duhet të dorëzohen në Departamentin përgjegjës për Licencim pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës
4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të shqyrtojë aplikacionin dhe mund të kërkojë informata shtesë



5. Koha e zakonshme e përpunimit të aplikacionit është deri në 30 ditë pas komentimit të dokumentacionit, përveç rasteve kur një furnizim i tillë ka natyrën prioritare dhe dosja është e kompletuar plotësisht;
6. Nëse miratohet aplikimi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të lëshojë një licencë me kushte dhe kufizime specifike të vlefshme për 3 (tri) vite, me mundësi përtëritje automatike, si licencë e patransferueshme.

Neni 6

Llojet e licencave për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Varësisht kërkesës dhe aplikimit për pajisje me licencë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të lëshojë lloje të ndryshme licencash, në varësi të valutave dhe vëllimeve të përfshira.
2. Llojet e licencave të aplikueshme sipas këtij udhëzuesi janë:
 - 2.1. Licencë me volum të lartë:
Lejon importin dhe eksportin e të gjitha valutave pa kufizim në shumë;
 - 2.2. Licencë e përgjithshme:
Lejon importin dhe eksportin e të gjitha valutave deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë;
 - 2.3. Licencë për valuta specifike:
Lejon importin dhe eksportin e një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë;
 - 2.4. Licencë e kufizuar:
Lejon vetëm importin e një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë;
 - 2.5. Licencë e kufizuar:
Lejon vetëm eksportin e një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë;

Neni 7

Përtëritja e licencës për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Licenca me kushte dhe kufizime specifike për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave përtërihet dhe vazhdohet në mënyrë automatike, nëse 30 ditë para skadimit të saj ajo nuk ndërpritet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
2. Gjatë fazës së licencës aktive, kërkesat nga neni 4 paragrafi 2 i këtij udhëzimi duhet të mirëmbahen nga institucioni financiar

Neni 8

Pranueshmëria e kërkesave për autorizime të veçanta për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Në përputhje me paragrafët 5 dhe 7 të nenit 40 të Rregullores për operacione me para të gatshme, kërkesat për autorizime të veçanta për import apo eksport të kartëmonedhave dhe monedhave mund të behet vetëm

nga institucionet financiare bankare ose jo-bankare qe tashme posedojnë një licencë të vlefshme për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, përkatësisht njërën nga licencat nga neni 6 i këtij udhëzimi

2. Transporti i tillë autorizohet vetëm për nevojat e vet institucionit financiar. Nëse kërkohet, bankat mund të importojnë apo eksportojnë edhe në emër dhe për një institucion financiar jo-bankar, nëse për një gjë të tillë ka një marrëveshje dhe licenca e dhënë sipas këtij udhëzimi ka parapare diçka të tillë.

Neni 9

Procesi i kërkesave dhe marrjes së autorizimeve të veçanta për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave

1. Për çdo import apo eksport të kartëmonedhave dhe monedhave, pavarësisht nga shuma, institucioni financiar bankar ose jo-bankar që duhet të marrë autorizim paraprak nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
2. Për të kërkuar autorizim të veçantë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave, institucioni duhet të ndjekë procedurën e mëposhtme:
 - 2.1. Për të siguruar kohë të mjaftueshme për shqyrtim dhe përpunim, plotësohet formulari [Kërkesë për autorizim të transportit të parave të gatshme] i kërkesës për autorizim të veçanta për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave dhe dorëzohet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të paktën 24 orë para transportit të planifikuar.
 - 2.2. Kërkesa për autorizim të veçantë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave duhet të dorëzohet në Departamentin përgjegjës për Menaxhimin e Parasë së Gatshme përkatësisht Divizionin e parave të gatshme, pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, përmes e-mail apo në forme fizike.
 - 2.3. Kërkesa për autorizim të veçantë për importin dhe eksportin e kartëmonedhave dhe monedhave bazohen në licencën përkatëse dhe mund të bëhet vetëm për shumatat, valutat dhe vendet e lejuara në licencë. Kërkesa duhet të paktën të përmbajë:
 - 2.3.1. Të dhënat mbi institucionin financiar bankar ose jo-bankar
 - 2.3.2. Detajet e kërkesës
 - 2.3.2.1. Lloji i kërkesës (Import i parave të gatshme ose Eksport i parave të gatshme)
 - 2.3.2.2. Mënyra e transportit (Transport Ajror, Transport Rrugor, Transport Hekurudhor)
 - 2.3.2.3. Data e saktë dhe koha e përafërt e transportit
 - 2.3.2.4. Kompania CIT e angazhuar
 - 2.3.2.5. Rrugëtimi fillestar dhe përfundimtar (Shteti, Qyteti i origjinës – Shteti, Qyteti i destinacionit)
 - 2.3.2.6. Origjina e parave të gatshme
 - 2.3.2.7. Destinacioni i fundit
 - 2.3.2.8. Valuta dhe shuma qe transportohet duke përfshirë strukturën nominale
 - 2.3.2.9. Qëllimi dhe arsyeja e plotë e importit apo eksportit
 - 2.4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do ta shqyrtojë kërkesën për import apo eksport të parave të gatshme dhe sipas nevojës mund të kërkojë informata shtesë.
 - 2.5. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës aprovon ose refuzon kërkesën për autorizimin apo mos autorizimin për import apo eksport parave të gatshme bazuar në pajtueshmërinë e kërkesës me rregulloren për operacionet me para të gatshme, licencën dhe vlerësimin të rrezikut.
 - 2.6. Institucioni financiar bankar ose jo-bankar do të njoftohet për autorizimin për realizimin e transportit përmes e-mail dhe/ose në forme fizike përmes formularit [Autorizim për transport të parave të gatshme].
 - 2.7. Në rast të mos-autorizimit, Institucioni financiar bankar ose jo-bankar do të njoftohet për mos-autorizimin për realizimin e transportit vetëm përmes e-mail.

Neni 10

Raportimi pas importit apo eksportit të kartëmonedhave dhe monedhave

1. Pas përfundimit të transportit, institucioni financiar bankar ose jo-bankar duhet të informojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës brenda 2 ditë pune pas realizimit të transportit
2. Informatat duhet të detajojnë shumën e transportuar, çdo mospërputhje nga autorizimi dhe konfirmimin e realizimit të sigurtë të dërgesës.
3. Raportimi i tillë behet për të evidentuar sasinë e parasë në qarkullim, me denominimet përkatëse.

Neni 11

Ruajtja e të dhënave dhe aspektet e tjera shtesë

1. Institucionet financiare bankare ose jo-bankare duhet të mbajnë shënime të detajuara për të gjitha lëvizjet e parave të gatshme, duke përfshirë origjinën, destinacionin, shumën, qëllimin dhe datën dhe t'i raportojnë ato në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës sipas kërkesës
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të realizojë inspektime të rregullta me ose pa paralajmërim për të verifikuar pajtueshmërinë me rregulloret dhe për të siguruar praktika të sigurta të transportit të parave të gatshme
3. Zbatimi i masave të forta të sigurisë gjatë gjithë procesit të transportit është thelbësor
4. Njohja me procedurat e sigurisë dhe atyre doganore për lëvizjen ndërkufitare të parave është thelbësore për të parandaluar komplikimet ose vonesat e paparashikuara
5. Ndarja e informacioneve të lartpërmendura behet në forme të dokumentit të kufizuar, ndërsa trajtohet në mënyrë konfidenciale
6. Siguria e transportit dhe rrethanat tjera konsiderohen plotësisht në përgjegjësinë e institucionit financiar

Neni 12


Shtojcat

1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi janë: Shtojca 1 dhe Shtojca 2.

Neni 13

Miratimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.
2. Efektet juridike të këtij Udhëzimi fillojnë me hyrjen në fuqi të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, më datën 1 shkurt 2024.



Ahmet Ismaili

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Shtojcë 1

[Kërkesë për licencë për lejimin e transportit të kartëmonedhave dhe monedhave]

Logo e institucionit
financiar

Datë: [Data e kërkesës]

Nga	[Emri i Institucionit Financiar]
	[Adresa e plotë e Institucionit Financiar] [Qyteti i Institucionit Financiar] Republika e Kosovës
Për	Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
	33 Garibaldi 10000, Prishtinë Republika e Kosovës
Departamenti	Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Tema	Kërkesë për licencë për lejimin e transportit të kartëmonedhave dhe monedhave

RE: Të nderuar,

Në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 40 të Rregullores për operacione me para te gatshme, përmes këtij aplikimi kërkojmë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të na pajisë me licencë për llojin e licencës të zgjedhur në tabelën e mëposhtme për shtetet e listuara në shtojcën A, për valutat e listuara në shtojcën B dhe sipas kufijve maksimal të shumave të transportit të kartëmonedhave dhe monedhave të listuara në shtojcën C:

Lloji i kërkesës për licencë

Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për të gjitha valutat pa kufizim në shuma	
Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për të gjitha valutat deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë	
Kërkesë për pajisje me licencë për import dhe eksport të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë	
Kërkesë për pajisje me licencë për import të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë	
Kërkesë për pajisje me licencë për eksport të parave të gatshme për një valute të caktuar ose grup valutash deri në një shumë të caktuar kufiri (ekuivalente në EUR) për secilën valutë	

* zgjidhni vetëm një opsion

Bashkangjitur: Dokumentacioni mbështetës

Me respekt

[Emri i personit të autorizuar të institucionit]

Nënshkrimi dhe data

Shtojcë 2 [Kërkesë për autorizim të transportit të parave të gatshme]



KËRKESË PËR AUTORIZIM TË TRANSPORTIT TË PARAVE TË GATSHME | ZAHEV ZA OVLAŠÇENJE ZA TRANSPORT GOTOVINE | REQUEST FOR AUTHORIZATION TO TRANSPORT CASH

1 TË DHËNAT MBI INSTITUCIONIN | PODACI O INSTITUCIJU | INSTITUTION DETAILS

Numri i institucionit Broj institucije Institution number	Emri i institucionit Ime institucije Institution name
Adresa Adresa Address	
Qyteti * Qend * City	Shteti * Drzava * Country

2 LLOJI I KËRKESËS PËR AUTORIZIM | VRSTA ZAHEVA ZA OVLAŠÇENJE | TYPE OF AUTHORIZATION REQUEST

Import i parave të gatshme | Uvoz gotovog novca | Import of cash

Eksporti i parave të gatshme | Izvoz gotovog novca | Export of cash

3 DATA E DHE KOHA E KËRKESËS * DATUM I VRJEME ZAHEVA * REQUEST DATE AND TIME

Data Datum Date	Koha Vrijeme Time	Shtime shtese Dodatni podatak Additional details
---------------------	-----------------------	--

4 DATA E SAKTË DHE KOHA E PERAFERT E TRANSPORTIT | TAÇAN DATUM I Približno vrijeme transporta | EXACT TRANSPORT DATE AND APPROXIMATE TIME

Data Datum Date	Koha Vrijeme Time	Mënyra e transportit Način transporta Mode of transportation	Kompania CIT CIT kompanija CIT company
---------------------	-----------------------	--	--

5 VALUTA, SHUMA, RRUGËTIMI, DESTINACIONI, ORIGJINA DHE QËLLIMI | VALUTA, IZNOS, PUT, ODREDIŠTE, PORJEKLO I CILJ | CURRENCY, AMOUNT, ROUTE, DESTINATION, ORIGIN AND PURPOSE

Valuta * Valuta * Currency	Shuma * iznos * Amount	Më fjollë * Recena * In words
Rrugëtimi prej - deri Putovanje od - do Route from-to	Destinacioni i fundit Posljednja destinacija Final dest.	
Origjina e parave Poreklo novca Origin of money	Qëllimi dhe arsyeja e transportit Svha i razoci za transport The purpose and reasons for the transport	

5.1 DETAJET E VALUTËS SË TRANSPORTUAR SIPAS DENOMINIMEVE | DETALJI O VALUTI KOJI SE PRENOSE PO APOENIMA | DETAILS OF TRANSPORTED CURRENCY BY DENOMINATIONS

Kartemonedha Novčanice Banknotes				Monedha Kovane novac Coins			
Den Apo Den.	# i copave # komada # of pieces	Shuma Iznos Amount		Den Apo Den.	# i copave # komada # of pieces	Shuma Iznos Amount	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
0		0.00		0		0.00	
Gjithsej kartemonedha Ukupno novčanice Total banknotes				Gjithsej monedha Ukupno kovani novac Total coins			
0.00				0.00			

6 MËNYRA E DËRGIMIT TË KËRKESËS * NAÇIN ISPORUKE ZAHEVA * REQUEST METHOD

Kjo kërkesë duhet të dorëzohet në BOK e shtypur në Detyrim të Operacioneve të Parave të Gatshme dhe Trazorit ose përmes postës elektronike tek isam: baltini@bok-ks.org, faton.gashi@tqe-ks.org dhe arinda.kastrati@bok-ks.org * Oryaj zehrev treba da se dclvada u CBK stampano kao Dvojna za Operacije sa Gotovim Novcem * Trazorom ili preko elektronske pošte kod isam: baltini@bok-ks.org, faton.gashi@tqe-ks.org dhe arinda.kastrati@bok-ks.org * This request has to be submitted to CBK in hard copy to Cash and Vault Operations Division or by email to isam.baltini@bok-ks.org, faton.gashi@tqe-ks.org dhe arinda.kastrati@bok-ks.org

Përmes postës elektronike | Preko elektronske pošte | By e-mail

Në formë të shtypur | Stampano | Hard copy

7 PERSONAT E AUTORIZUAR TË INSTITUCIONIT | AUTORIZOVANI LICA INSTITUCIJE | AUTHORIZED PERSONS OF THE INSTITUTION

Person i autorizuar 1 Ovlaśceno lice 1 Authorized Person 1	Person i autorizuar 2 Ovlaśceno lice 2 Authorized Person 2
Adresa e postës elektronike Adresa elektronske pošte E-mail address	Adresa e postës elektronike Adresa elektronske pošte E-mail address

